




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- C1 Regjistri i pasurisë ishte nënvlerësuar pasi që ministria gjatë vitit 2023 nuk kishte arritur të bëjë një vlerësim financiar për 129 pronat e identifikuara të Institutit Bujqësor të Kosovës (IBK) si dhe t'i evidentoj/regjistrojë ato në regjistrat e pasurisë. Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të identifikoj vlerën financiare të mos-regjistrimit por gabimi konsiderohet material në aspektin e keq-deklarimit.
- B1 Tre pagesa në vlerë të përbashkët 20,144€ janë paguar nga kategoria jo-adekuate ekonomike.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Kontratat e nënshkruara në mes MBPZhR-së dhe Operatorëve ekonomik për tetë (8) lote në kuadër të projektit: “Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes në komunat Mitrovicë, Vushtri, Kamenicë, Shtime, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik” në vlerë të përbashkët prej 2,196,484€, nuk ishin realizuar dhe finalizuar sipas afatit kohor të kontraktuar.
- A2 Ministria kishte angazhuar 12 konsulentë me marrëveshje për shërbime të veçanta përmes procedurave të prokurimit për t'i plotësuar pozitat e rregullta të punës. Kontratat janë lidhur për periudhë tri vjeçare në vlerë totale prej 225,666€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) është agjenci ekzekutive e cila ka kaluar në kuadër të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural sipas Ligjit për ushqim 08/L-120. Si rezultat, buxheti i AUV-së nga viti 2023 ka kaluar në kuadër të ministrisë, ndërsa në vitin 2022 ishte pjesë e Zyrës së Kryeministrit (ZKM).

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbytjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm janë menaxhimi i pasurisë me theks të veçantë vlerësimi dhe regjistrimi i 129 pronave të IBK-së në regjistra të pasurisë si dhe klasifikimi adekuat i shpenzimeve.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, AUV duhet t'i forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurive të përfunduara dhe t'i funksionalizoj ato. Poashtu, ministria t'i kushtoj vëmendje të shtuar menaxhimit më efikas të kontratave brenda kohëzgjatjes së tyre për t'i shmangur vonesat në realizim dhe finalizim të tyre. Gjithashtu duhet të shmanget aplikimi i procedurave të prokurimit për plotësim të pozitave të rregullta të punës.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja, një (1) i përsëritur dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e pronave

Gjetja

Rregullorja MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Ministria nuk i ka të evidentuara në regjistrin e pasurive 129 prona tokësore të IBK-së. Për këto prona, ministria ka nënshkruar kontratën për "Vlerësimin financiar të pronave dhe aseteve të paluajtshme të Institutit Bujqësor të Kosovës" me 13.02.2024 dhe për këtë arsye nuk ka arritur ti regjistrojnë në regjistrat e pasurive as për vitin 2023, duke nënvlerësuar pasuritë kapitale.

Pamundësia e regjistrimit të pronave në regjistrat e pasurisë kishte ndodhur për shkak të kompleksitetit të procesit të identifikimit të pronave në njërën anë, ku disa prona ishin identifikuar si të tjetërsuara/uzurpuara të cilat janë në emër të IBK-së, ndërsa në anën tjetër për shkak të kohës së kufizuar për vlerësimin financiar të tyre dhe inkorporimin e shënimeve në Pasqyra financiare.

Ndikimi

Mos regjistrimi i drejtë i pasurisë sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloret për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon në prezantimin e informatave jo të sakta në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me vlerësimin e pronave brenda afatit të përcaktuar me kontratë dhe regjistrimin e drejtë të pasurive jo financiare në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Neni 3 (paragrafi 1.3) i Udhëzimit Administrativ MF-nr.04/2019 për definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale, “Shpenzimin Rrjedhës të Projektit Kapital” e përkufizon si shpenzim që lidhet me menaxhimin, riparimin, mirëmbajtjen apo aktivitetet minore të asetit, përfshirë këtu shpenzimet që ndodhin pas përfundimit të projektit e që kanë të bëjnë me operimin dhe mirëmbajtjen e asetit.

Lidhur me këtë, nga mostrat e testuara kemi identifikuar:

Pagesa në vlerë 16,464€ për kontratën “Programi Kombëtar për inventarizimin e tokave bujqësore në Republikën e Kosovës - Servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve laboratorike Loti 2” ishte paguar nga kategoria e investimeve kapitale, përderisa për nga natyra i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve sepse ka të bëjë me servisim dhe kalibrim të pajisjeve laboratorike të IBK-së.

Po ashtu, dy pagesa në vlerë 3,680€ të realizuara nga AUV, në kuadër të kontratës “Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit për çertifikata dhe pagesa elektronike”, ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale. Shpenzimet për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, pasi kanë të bëjnë me mirëmbajtjen mujore të sistemit për çertifikata dhe pagesa elektronike për të cilën paguhet një tarifë fikse mujore. Ky keq-klasifikim ka ndikuar edhe në mbivlerësimin e gjendjes së pasurisë së regjistruar në SIMFK për të njejtën shumë.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur për shkak se planifikimi i këtyre projekteve ishte bërë në kategorinë jo adekuate të shpenzimeve.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësim/nënvlerësim të kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe rrjedhimisht në paraqitje jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestিনি i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesë në realizim të projektit

Gjetja

Kontratat e nënshkruara në mes MBPZhR-së dhe Operatorëve ekonomik për tetë (8) lote në kuadër të projektit: “Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes në komunat Mitrovicë, Vushtri, Kamenicë, Shtime, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik”, në kushtet e veçanta të kontratës (KVK) parashohin se data e përfundimit të të gjitha punëve do të jetë 85 ditë kalendarike, ashtu siç është specifikuar edhe në dosjen e tenderit.

Në të gjitha kontratat e nënshkruara për tetë (8) lote, kishte vonesa në realizim të punimeve në raport me afatet kohore të kontraktuara. Deri në përfundim të auditimit, asnjëra nga kontratat nuk ishte përfunduar. Shkalla e realizimit të kontratave për “Ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujitjes në komuna” janë paraqitur më poshtë duke u bazuar në raportin e Menaxherit të kontratës. Ndërsa ditët e vonesave i kemi llogaritur përtej afatit të theksuar në KVK (85 ditë kalendarike) deri në datën e përfundimit të ekzekutimit të auditimit 15.03.2024, si në vijim:

- Komuna Mitrovicë, kontrata në vlerë 343,259€ ishte nënshkruar me datë 23.11.2022 (393 ditë vonesë në realizim), ndërsa vlera e realizuar e kontratës ishte 82,299€ apo 24%;
- Komuna Vushtri, kontrata në vlerë 185,235€ ishte nënshkruar me datë 23.11.2022 (393 ditë vonesë në realizim), ndërsa vlera e realizuar e kontratës ishte 107,520€ apo 58%;
- Komuna Kamenicë, kontrata në vlerë 232,957€ ishte nënshkruar me datë 23.11.2022 (393 ditë vonesë në realizim). Nga kjo kontratë nuk ishte zhvilluar asnjë punim (shkalla e realizimit ishte 0%);
- Komunën Shtime, kontrata në vlerë 336,475€ ishte nënshkruar me datë 23.11.2022 (393 ditë vonesë në realizim), ndërsa vlera e realizuar e kontratës ishte 17,902€ apo 6%;
- Komuna Klinë, kontrata në vlerë 285,831€ ishte nënshkruar me datë 24.02.2023 (300 ditë vonesë në realizim), ndërsa vlera e realizuar e kontratës ishte 195,060€ apo 69%;
- Komuna Istog, kontrata në vlerë 277,345€ ishte nënshkruar me datë 23.11.2022 (393 ditë vonesë në realizim). Nga kjo kontratë nuk ishte zhvilluar asnjë punim (shkalla e realizimit ishte 0%);
- Komuna, Deçan, kontrata në vlerë 346,957€ ishte nënshkruar me datë 14.03.2023 (282 ditë vonesë në realizim), ndërsa vlera e realizuar e kontratës ishte 92,501€ apo 27%; dhe
- Komuna Junik, kontrata në vlerë 188,425€ ishte nënshkruar me datë 24.02.2023 (300 ditë vonesë në realizim), ndërsa vlera e realizuar e kontratës ishte 95,773€ apo 51%.

Disa nga faktorët që kishin ndikuar në vonesa në realizim të punëve ishin: mos-fillimi i punimeve me kohë për shkak të sezonës së dimrit, kontraktimi i kompanisë mbikëqyrëse, probleme në dizajnimin e projekteve që ishte përgjegjësi e komunave, probleme pronësore, probleme me fermer etj. Rrjedhimisht, projekti ishte inicuar pa një analizë të bazuar dhe përgatitje paraprake të rrethanave që e ndikojnë realizimin e projektit.

Ndikimi

Vonesat në realizimin dhe përfundimin e projekteve ndikojnë në mos përmbushjen e objektivave të përcaktuara të Ministrisë si dhe mund të të

shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese. Po ashtu, kjo ndikon në mos kryerjen me kohë të shërbimit ndaj përfituesve të projektit.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të siguroj që për të gjitha projektet e pa-përfunduara të aplikohen dëmet e likuiduara si dhe të merren të gjitha masat që parashihen me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratave. Po ashtu, para inicimit të çdo procedure të prokurimit duhet të sigurohet se janë marrë parasysh të gjitha kushtet që e ndikojnë realizimin e projektit përfshirë këtu dizajnin e duhur të projektit, zgjidhjen e problemeve pronësore dhe faktor të tjerë me ndikim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Angazhimi i konsulentëve përmes procedurave të prokurimit për mbulimin e pozitave të rregullta

Gjetja

Sipas Rregullave për prokurim të shërbimeve të veçanta (Konsulentët/Kontraktorët individual), përkatësisht neni 3.1 përcakton se këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilët nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyratet Publik nr. 06-L-114. Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbimet profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por që nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka. Më tej, neni 3.2 përcakton se Konsulenti/Kontraktori individual është një specialist në një fushë specifike, i angazhuar nga Autoriteti Kontraktues në rolin e një këshilluesi.

Gjatë vitit 2023 ministria kishte angazhuar 12 konsulentë për nevoja të AZHB-së (kontroller) me marrëveshje për shërbime të veçanta përmes procedurave të prokurimit. Kontratat ishin lidhur për periudhë tri vjeçare në vlerë totale prej 225,666€. Nga testimi i një kontrate në vlerë 19,440€ me kohëzgjatje tri vjeçare, rezulton se pozitat e mbuluara me konsulent janë pozita të rregullta të punës (inspektor) në kuadër të ministrisë, të cilat është dashur të plotësohen përmes procedurave të rekrutimit.

Mos aplikimi i procedurave të duhura të angazhimit të personelit për nevojat e ministrisë ishte ndikuar nga kufizimet në shpalljen e konkurseve të jashtme, dhe pamjaftueshmëria e personelit të angazhuar në raport me detyrat dhe përgjegjësitë që ka kjo ministri.

Ndikimi

Mbulimi i pozitave të rregullta të punës përmes procedurave të prokurimit, ndikon në cilësinë e punës dhe nuk ofron bazën e drejtë të angazhimit të tyre për faktin e mos respektimit të procedurave të rekrutimit.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të gjej një zgjidhje të qëndrueshme në përputhje me kërkesat ligjore lidhur me plotësimin e nevojave të ministrisë për personel shtesë, kështu pozitat e rregullta të punës të përfshihen në planin e rekrutimeve, dhe të sigurohet rekrutimi i personelit të nevojshëm përmes procedurave të rekrutimit në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 46,488,999€, pasurive jokapitale është 252,044€, si dhe e stoqeve 372,878.

Çështja A3 - Mos vënia në përdorim e pasurisë

Gjetja Rregullorja MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 11.3 përcakton se, pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Lidhur me projektin për "Ndërtimin e fabrikës së riciklimit të nën-produkteve me origjinë shtazore" ka përfunduar procesi i investimit por ende nuk është në përdorim. Projekti ishte një financim i planifikuar dhe realizuar në bashkëpunim me Komisionin Evropian. Pjesa e investuar deri më tani nga AUV për këtë projekt arrin shumën prej 5,299,502€. Sipas çertifikatave të pranimit të përkohshëm (viti 2019) ndërtimi i objektit të fabrikës është përfunduar sipas kërkesave të projektit dhe është i gatshëm të vihet në përdorim. Krahas kësaj, të gjitha pajisjet për punën e fabrikës janë të vendosura dhe të testuara. Në regjistrat e pasurive vlera e objektit, 1,062,412€ (pa përfshirë vlerën e pajisjeve), figuron si investim në vijim.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar dy raporte të fizibilitetit për vënien në punë të fabrikës. Raportet kishin për qëllim të dalin me rekomandime për mundësitë e vënies në përdorim të kësaj fabrike. Së fundmi, përmes një komisioni të brendshëm është bërë vlerësimi i gjendjes së objektit dhe opsionet e funksionalizimit. Ky komision, nëpërmjet raportit të përgatitur shtjellon gjendjen e fabrikës dhe jep rekomandimet përmes opsioneve më të favorshme për vënien në punë të fabrikës.

Kjo situatë vjen si rezultat i investimit të pa mbështetur në një analizë të qëndrueshme paraprake.

Ndikimi Mos vënia në përdorim e pasurisë, ka ndikuar në mos arritjen e qëllimit të përcaktuar me kohë, e cila njëkohësisht ndikon në zhvlerësimin e pasurisë për nga aspekti kohor, pa u shfrytëzuar fare, duke i shtuar kësaj edhe shpenzimet tjera të sigurimit dhe mirëmbajtjes.

Rekomandimi A3 Ministri në bashkëpunim me AUV duhet të ndërmarrë veprime konkrete drejt vënies në përdorim të fabrikës së riciklimit të nën-produkteve me origjinë shtazore. Duke pas parasysh investimin e bërë, duhet ti kushtohet kujdes rrethanave të mundshme të cilat mund të pengojnë vënien në përdorim të këtij projekti.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	86,710,224	93,562,272	91,094,842	77,257,371	74,998,863
Grante Qeveritare - Buxheti	86,366,383	92,689,882	90,705,258	74,545,887	71,157,826
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	1,126,009	1,917,705
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	1,526,931	1,777,899
Të bartura nga viti i kaluar	0	343,841	183,155	58,544	112,342
Të hyrat vetanake	343,841	343,841	196,368	0	33,092
Donacionet e jashtme	0	184,707	10,061	0	0

Buxheti final i MBPZhR në raport me buxhetin fillestar është rritur për 6,852,048€. Ky ndryshim është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore, përfshirjes së të hyrave të bartura, të hyrave të pranura nga fondet e donatorëve si dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2023, MBPZhR ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 91,094,842€, me një rritje prej 6% në raport me vitin paraprak. Megjithatë të dhënat e viteve 2022 dhe 2021 nuk përfshijë të dhënat e AUV-së e cila ishte pjesë e “Zyrës së Kryeministrit” (ZKM) në këto vite, prandaj krahasimi i performancës me vitet paraprake nuk paraqet matje reale.

Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	86,710,224	93,562,272	91,094,842	77,257,371	74,998,863
Pagat dhe mëditjet	5,137,006	4,966,809	4,966,809	2,458,724	2,468,689
Mallrat dhe shërbimet	6,436,513	4,743,259	3,401,056	2,404,100	2,096,169
Komunalitë	215,683	190,683	119,715	56,367	72,956
Subvencionet dhe transferet	68,947,022	81,825,513	81,492,355	70,262,987	67,989,985
Investimet Kapitale	5,974,000	1,836,007	1,114,906	2,075,193	2,371,064

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë.

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 170,197€. Ky ndryshim ishte rezultat i zvogëlimit të mjeteve me vendim të Qeverisë në vlerë 176,497€, si dhe të hyrave nga fondet e donatorëve në vlerë 6,300€ (në AUV). Shpenzimi në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte 100%.


Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,693,254€. Ky ndryshim ishte rezultat i alokimit të të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë 343,841€ (në APK dhe AUV), të hyrat nga grantet e donatorëve në vlerë 92,905€ (në AUV), zvogëlim për transferin prej 400,000€ në kategorinë subvencione dhe transfere, si dhe zvogëlimit të mjeteve sipas vendimeve Qeveritare në vlerë 1,730,000€. Shpenzimi në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte 72%.

Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 25,000€ si rezultat i zvogëlimit me vendim të Qeverisë. Shkalla e realizimit të buxhetit në këtë kategori ishte 63%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 12,878,491€. Kjo rritje ishte rezultat i transferit të mjeteve në vlerë 400,000€ nga kategoria mallra dhe shërbime dhe transferit në vlerë 2,079,536€ nga kategoria e investimeve kapitale. Po ashtu kishte rritje nga ndarja e mjeteve me vendime Qeveritare në vlerë 12,023,955€, me qëllim të pagesës së obligimeve të mbetura për subvencione në bujqësi si dhe zvogëlim me vendim për kursime në vlerë 1,625,000€. Shpenzimi i realizuar në këtë kategori në raport me buxhetin final ishte rreth 100%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,137,993€. Ky ndryshim ishte rezultat i transferit të mjeteve në vlerë 2,079,536€ në kategorinë subvencione dhe transfere, vendimeve Qeveritare për kursime në vlerë 2,143,959€, si dhe fondeve të pranuar nga donatorët në vlerë 85,502€ (në AUV). Shkalla e realizimit të buxhetit final në këtë kategori ishte 61%. Në këtë nivel të realizimit kanë ndikuar mos iniciimi i një pjese të madhe të projekteve si dhe vonesave në realizim të projekteve të kontraktuara.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MBPZhR në vitin 2023 ishin në vlerë 9,384,032€. Kjo rritje e theksuar krahasuar me vitet paraprake ka të bëjë me kalimin e AUV-së në kuadër të MBPZhR-së, ku të hyrat e realizuara nga AUV përfshijnë 75% të të hyrave totale të realizuara në kuadër të ministrisë.

Të hyrat kryesisht kanë të bëjnë me inspektime sanitare, fitosanitare dhe veterinare, shfrytëzimi i pronës publike, lëshimi i licencave, të hyrat nga qiraja e tokës së dhënë në shfrytëzim etj. Të hyrat tjera në vlerë 109,711€ kanë të bëjnë me kthimet e mjeteve nga viti i kaluar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	3,094,871	3,094,871	9,384,032	2,570,437	2,680,063
Të hyrat jo tatimore	3,094,871	3,094,871	9,274,321	2,500,467	2,664,098
Të hyrat tjera	0	0	109,711	69,970	15,966

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka rezultuar me 8 rekomandime. Krahas tyre, në progresin e zbatimit të rekomandimeve kemi përfshirë edhe 3 rekomandime për AUV si rezultat i raportit të vitit paraprak të “Zyrës së Kryeministrit” pjesë e të cilës ishte kjo agjenci.

Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t’i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria për vitin 2023 po ashtu kishte përgatitur një raport periodik për progresin në zbatimin e rekomandimeve ku janë paraqitur veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, nga 11 rekomandime të dhëna, tetë (8) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim nuk është zbatuar, një (1) rekomandim është zbatuar pjesërisht si dhe një (1) rekomandim është mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se për pronat e identifikuar të bëhet vlerësim financiar dhe të njëjtat të regjistrohen në regjistrin e pasurisë. Po ashtu, duhet të sigurojë se zyrtari i pasurisë të regjistrojë vetëm pasuritë të cilat i plotësojnë kriteret për regjistrim, në mënyrë që të mundësohet regjistër i saktë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PVF.	Ministria ka nënshkruar kontratën për "Vlerësimin financiar të pronave dhe aseteve të paluajtshme të Institutit Bujqësor të Kosovës" me 13.02.2024 e cila pritet të përfundoj pas gjashtë muajve. Në anën tjetër, vlera e gabimeve për mbivlerësim/nënvlerësim të pasurive është zvogëluar dukshëm këtë vit. Ndërsa AUV, ka regjistruar blerjet e vitit për pasuritë nën 1,000€ dhe është në proces të identifikimit dhe regjistrimit të pasurive të paregjistruara më herët.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë planifikimin e buxhetit në përputhje me natyrën e projekteve në mënyrë që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Edhe këtë vit kemi hasur në keqklasifikim të shpenzimeve. Shih çështjen B1.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë bërë rregullimet e nevojshme në normën e zhvlerësimit për projektin në fjalë, duke siguruar që regjistri i pasurive të jetë i kategorizuar drejtë në mënyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofrojë informata të sakta dhe të drejta në PVF.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla, norma e zhvlerësimit për pasuritë është korrigjuar.	I zbatuar

4.	Baza për konkluzion	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it duhet të sigurohen që të nxjerrën urdhërblertet para se të pranohen mallrat dhe faturat në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blertet e pa kontrolluara.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it duhet të forcojnë masat e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve financiar dhe zyrtarëve tjerë administrativ për të siguruar se të gjitha obligimet do të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësit e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.	Nuk kemi identifikuar mangësi të tilla këtë vit.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeshefi Ekzekutiv i AUV-it duhet të marrin veprimet e nevojshme për të siguruar vlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e vendosura në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit. Më tej Zyrtari i prokurimit duhet të sigurojë se nëse vlera e parashikuar e kontratës është llogaritur si e veçantë për secilin llotë (pjesë) të ceket në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit si e tillë.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se programi për zhvillim rural aprovohet pas miratimit të Ligjit të buxhetit vjetor me qëllim të harmonizimit të tij me ciklin buxhetor, thirrjen për ndarjet vjetore të granteve si dhe ekzekutimin e pagesave brenda vitit të jenë në përputhje me buxhetin e aprovuar vjetor.	Çështjet që kanë të bëjnë programin e zhvillim rural janë trajtuar tek Raporti i auditimit të Performancës.	Nuk është i aplikueshëm më
9.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që komisionet përkatëse pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjnë harmonizimin me gjendjen në regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve, me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen e saktë të pasurive me të cilat disponon ministria. Po ashtu, pasuria jashtë përdorimit të përfshihet në raportet e tjetërsimit dhe e njëjta të largohet nga regjistri i pasurisë.	Ministria ka marr masa, është formuar lista e automjeteve të dëmtuara dhe në kuadër të qeverisë është formuar komisioni për vlerësimin e tyre.	I zbatuar

10.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të siguroj efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke ndërmarrë të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga dhënia me qira të tokave bujqësore. Po ashtu, duhet të sigurohet se janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe në kohë që pronat e Ministrisë nuk shfrytëzohen pa kontratë.	Këtë vit nuk kemi hasur në ndonjë rast të shfrytëzimit të tokës pa kontratë. Në rastin e identifikuar nga viti paraprak ishte bërë pagesa e pjesës më të madhe të borxhit ndërsa pjesa e mbetur ishte raportuar si llogari e arkëtueshme.	I zbatuar
11.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se plani vjetor i auditimit aprovohet me kohë si dhe auditimet kryhen sipas planit të aprovuar, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës.	NJAB në AZHB ka plotësuar pozitën e udhëheqësit të njësisë, plani i auditimit është realizuar.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit




Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Faton PEÇI

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Data: 21. Maj. 2024, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.